

MANUALI I PËRDORIMIT TË E-BANKING PËR INDIVID

© Të drejtat e autorit BKT 2021. Të gjitha të drejtat e rezervuara

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, përkthehet, përshtatet, rregullohet, ose të ndryshohet në çdo lloj mënyre, të shpërndahet, komunikohet, huazohet, ruhet në sisteme të dhënash, apo të transmetohet në çdo formë a mënyrë, elektronike, mekanike, të fotokopjohet, regjistrohet apo të shfaqet për publikun, apo të jetë objekt i çdo veprimi apo aktiviteti që ligji e mbron në favor të zotëruesit të të drejtës së autorit, pa lejen paraprake me shkrim nga BKT.

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	4
1. Regjistrimi në platformën E-banking	6
1.2. Procesi i regjistrimit në platformën e-banking	7
1.2.1 Regjistrimi me të dhënat e kartës	7
1.2.2 Regjistrimi me kod Unik	8
2. Kyçja në e-banking	9
2.1 Kyçja me numër të klientit/letërnjoftimi	9
2.2 Kyçja me të dhënat e kartës dhe kodin PIN	10
3. Faqja Kryesore	11
4. Funksionet dhe Shërbimet në e-banking	13
4.1 Llogaritë	13
4.1.1 Llogaritë e mia	13
5. Depozitat	15
5.1 Depozitat e Mia	15
5.2 Hapja e depozitës	16
5.2.1 Hapja e një depozite nëpërmjet Listës së Produkteve të Bankës	16
5.2.2 Hapja e një depozite nëpërmjet Datës së Maturitetit	17
6. Karta e Debitit	19
6.1 Lidhja e Llogarisë	19
6.2 Ndarja e Llogarisë	19
7. Karta e Kreditit	20
7.1 Kartat e mia	20
7.2 Ndaje me këste	21
7.3 Pagesa e Kartës time	21
7.5 Paradhënie	23
7.6 Ndaje me Këste	23
7.7 Pagesa e Kartës të tjerëve	23
7.8 Limiti në Internet	24
8. Transferet	24
8.1 Transfertat mes llogarive të mia	25
8.2 Transfertat mes llogarive në BKT	26
8.3 Transfertat brenda vendit	27
8.4 Transferta të regjistruara	28
8.5 Historiku i transfertave	28
8.6 Transfertat në BKT Shqipëri	29
8.7 Transfertë Ndërkombëtare	30

9. Pagesat.....	33
9.1 Pagesë e faturave me Uniref	33
9.2 Pagesë e faturave me Giro.....	34
9.3 Pagese Fature	35
9.5.1 Pagesë e faturave KESCO/KUR	35
9.4 Faturat e Paguara.....	36
9.5 Autorizimet	37
9.6 Fatura me Autorizime	38
10. Shërbimet.....	39
10.1 Rimbushje Celulari/Telefoni.....	39
10.2 Pagesë e shërbimeve të kombinuara / Internetit/ Televizionit IPKO	41
11. Kreditë	42
12. Kredi Dixhitale.....	43
13. Investimet	45
13.1 Këmbimi Valutor	45
13.2 Kursi i këmbimit valutor	46
14. Personalizime	47
14.1 Ndryshim Fjalëkalimi	47
14.2 Limitet e veprimeve	47
14.3 Pulla dixhitale.....	48
14.4 Kufizim llogarie	48
15. Informacione	49
15.1 Njoftime nga aplikacioni BKT Mobile:.....	49
15.2 Informacion kontakti	49

HYRJE

BKT e-banking

BKT e-banking është një sistem pagese elektronike që ju mundëson të kryeni një sërë transaksionesh nga distanca duke përdorur një pajisje kompjuterike apo mobile siç është smartphone ose tablet. E-banking është në dispozicion 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë.

Për tu kyçur në e-banking ju duhet të vizitoni ueb faqen e bankës <https://bkt-ks.com/> dhe të përzgjidhni pjesën “e-banking” për individ.

BKT ofron shërbimet për klientë individualë dhe të biznesit në gjuhë shqipe dhe në gjuhën angleze në platformën e-banking.

Beneficionet:

Komoditet

Tani Interneti me shpejtësi të lartë ka hyrë në çdo shtëpi, me aplikacionet bankare është bërë jashtëzakonisht e lehtë të kryeni transaksione bankare nga komoditeti i shtëpisë, zyrës apo vendpushimi juaj pa marrë parasysh se ku jeni dhe në çdo kohë që keni nevojë.

Kursimi Kohës

Një nga përfitimet kryesore të përdorimit të e-banking është se ka bërë të mundur të keni qasje në llogarinë tuaj pa i vizituar degët e bankës. Ju nuk keni nevojë të humbni kohë duke pritur në radhë në degë, për të kryer veprime bankare, por mund ti kryeni ato vetë 24x7 sa herë që të jetë e nevojshme.

Kursimi i Parave

Duke ju dhënë komoditetin ti kryeni vetë veprimet bankare, po ashtu banka ju mundëson ti kryeni një numër të madh veprimesh pa komision apo me komisione më të ulëta se ato në degë.

Më shumë siguri

Platforma e-banking ka një sistem me nivel të lartë të sigurisë që kërkon të bëjë verifikimin tuaj me disa hapa para se të kyçeni në llogari duke zvogëluar kështu rreziqet e keqpërdorimit.

Këto hapa përfshijnë: numrin tuaj të klienti apo numrin tuaj personal, një fjalëkalim dhe një imazh i sigurisë që keni përcaktuar gjatë regjistrimit në e-banking apo numrin tuaj të kartës dhe PIN-in dhe një kod për një përdorim që do ta pranoni në numrin tuaj të telefonit.

Monitorimi i financave tuaja

Menaxhimi i llogarive tuaja përmes platformës e-banking ju vë përgjegjësinë e monitorimit të parave tuaja dhe ju ndihmon të vlerësoni më mirë gjendjen tuaj financiare. Në çdo moment mund të monitoroni të hyrat, shpenzimet dhe obligimet tuaja bankare.

Kontribuoni në ruajtjen e mjedisit/ambientit

Me përdorimin e platformës e-banking ju kontribuonin në ruajtjen e mjedisit. Nuk është e nevojshme përdorimi i letrës, pasi që çdo njoftim i kryerjes transaksionit bëhet në mënyrë elektronike. Kjo ndikon në një mjedis më të mirë, dhe ju bëheni kontribues në ruajtjen e ambientit.

Shërbimet Bankare dhe Informatat në platformën e-banking

Në platformën e-banking mund të kryeni shërbimet dhe merrni informatat si në vijim :

Veprimet me llogaritë:

- ✓ Monitorimi i gjendjes dhe veprimeve së llogarive
- ✓ Gjenerimi i gjendjes së llogarisë (dërgohet në e-mailin tuaj të vendosur në sistem)
- ✓ Hapja e llogarive të reja në: EUR, USD, CHF, GBP dhe TLL

Depozitat

- ✓ Hapja e depozitës së re
- ✓ Monitorimi i depozitave tuaja

Kartat e Debitit

- ✓ Mund të lidhni edhe një llogari dytësore me kartën tuaj
- ✓ Mund të largoni/ndani lidhjen e llogarisë nga karta juaj

Karta e Kreditit:

- ✓ Monitoroni pasqyrat mujore të kartës
- ✓ Monitoroni transaksioneve e fundit
- ✓ Paguani kartën tuaj apo karta të tjerëve
- ✓ Kaloni paradhënien nga karta juaj në llogarinë tuaj rrjedhëse
- ✓ Ndryshoni limit e pagesave online
- ✓ Ndani me këste pagesat (kur lejohet nga banka)

Transferim parash:

- ✓ Në mes llogarive tuaja
- ✓ Brenda llogarive të bankës BKT-s
- ✓ Brenda vendit
- ✓ Tek llogaritë në BKT Shqipëri.
- ✓ Transferte ndërkombëtare

Pagesa të faturave:

- ✓ KESCO dhe KUR Prishtina
- ✓ me KosGiro për kolektor të ndryshëm si: Kompanitë e Sigurimeve, Universitet dhe Kompani të tjera
- ✓ me Uniref -buxheti i Kosovës si: fatura të Taksave Komunale, fatura të Ministrive dhe institucioneve
- ✓ Krijimi i urdhërit për pagesa automatike

Monitorimi i Kredive:

- ✓ Shuma dhe data e kështit mujor
- ✓ Bilanci i mbetur
- ✓ Data e përfundimit
- ✓ Plani i kthimit të kredisë

Aplikimi Digjital:

- ✓ Aplikimi për Kredi Dixhitale
- ✓ Aplikimi për Kredi Kartë Dixhitale (së shpejti)
- ✓ Aplikimi për Mbitërheqje Dixhitale (së shpejti)

Smart Invest (investimi në tregjet financiare botërore)*

- ✓ Fillo shërbimin
- ✓ Monitoro tregun tuaj të përzgjedhur
- ✓ Investoni fondet tuaja në tregjet financiare botërore
- ✓ Tërhiqni fondet tuaja të investuara
- ✓ Mbyllni shërbimin

* Për të hapur këtë shërbim duhet të aplikoni në degë

Shërbime tjera:


- ✓ Këmbim Valutash
- ✓ Mbushje elektronike të telefonit nga operatorët e telefonive mobile
- ✓ Monitorimi dhe Konfigurimi i njoftimeve për BKT Mobile
- ✓ Informata për fushata
- ✓ Ndryshimi i fjalëkalimit
- ✓ Monitorimi/ndryshimi i limiteve të veprimeve bankare
- ✓ Vendosja/ndryshimi e-mail adresës

1. Regjistrimi në platformën E-banking

Për tu regjistruar në platformën e-banking, fillimisht është e nevojshme:

- Të keni të hapur një llogari bankare për individ
- Të keni mbushur 18 vjet
- Numri i klientit*
- Të keni kartë aktive debitit/kreditit dhe dini PIN-in
- Çasje në numrin e telefonit tuaj të regjistruar në bankë ku do të pranoni FNP**
- Një pajisje kompjuterike apo pajisje mobile, telefon ose tablet me qasje ne internet

Fillimisht hyni në ueb faqen e bankës në adresën <https://bkt-ks.com/> dhe zgjidhni butonin e-banking pastaj në opsionet e paraqitura duhet të klikoni “Individ”, ku do të hapet faqja e radhës për të filluar procesin e kyçjes.



Shënim

*Numri i Klientit është numri unik 9 shifror që keni pranuar gjatë procesit të hapjes së llogarisë.
Nëse nuk ju kujtohet mund të kontaktoni Qendrën Kontaktuese në 038 666 666

**FNP- është Fjalëkalimi për Një Përdorim të cilin do ta pranoni me SMS në numrin tuaj të cilin e keni të regjistruar në sistemin tonë


1.2. Procesi i regjistrimit në platformën e-banking

Për filluar përdorimin duhet të bëhet regjistrimi i përdoruesit. Regjistrimi mund të kryhet në këto mënyra:

- me të dhënat e kartës (nëse keni kartelë aktive Debit apo Kredit)
- përmes Kodit Unik – një kod të cilin do ta pranoni përmes SMS-it, në momentin që hapet llogaria në BKT nga zyrtari i bankës

1.2.1 Regjistrimi me të dhënat e kartës

Në ekran zgjidhni butonin “**Regjistrohu**”:



The first screenshot shows the 'Hyrje' (Login) screen. It has two tabs: 'Me Numër Klienti' and 'Me Kartë'. Under 'Me Kartë', there are fields for 'Numri Klienti / Numri Personal' (712345678 / A123456780) and 'Fjalëkalimi' (password). There is a checkbox for 'Përdor Tastierën Virtuale' (Use Virtual Keyboard) and a 'Vazhdo >' button. A Norton logo is also present. A red box highlights the 'Regjistrohu tani' (Register now) link at the bottom.

The second screenshot shows the 'Regjistrimi' (Registration) screen. It has two tabs: 'Me Kartë' and 'Me Kod Unik'. Under 'Me Kartë', there is a dropdown for 'Tipi Kartës' (Card Type) set to 'Master Gold- Prima Gold'. There are fields for '4 Numrat e Fundit' (Last 4 digits) set to '8716' and 'Kodi PIN' (PIN code). There is a checkbox for 'Përdor Tastierën Virtuale' (Use Virtual Keyboard) and a 'Vazhdo >' button. A Norton logo is also present.

Hapi 1 - zgjidhni opsionin me kartë dhe vendosni të dhënat e kartës:

- Zgjidhni tipin e kartës tuaj;
- Vendosni 4 numrat e fundit të kartës që keni përzgjedhur;
- Vendosni PIN e kartës që keni përzgjedhur.


Pas vendosjes së të dhënave të kartës, do të dërgohet një SMS me kodin FNP (Fjalëkalim një përdorimesh)

Hapi 2 - vendosni një fjalëkalim i cili do të përdoret për kyçjen në e-banking apo aplikacionin BKT Mobile, sipas kriterëve përcaktuara më poshtë:

- Fjalëkalimi duhet të jetë nga 6 deri në 16 karaktere dhe të përmbajë karaktere alfa numerike (shkronja/ numra)
- Fjalëkalimi nuk duhet të jetë i njëjtë me datëlindjen tuaj (DD/MM/VVVV)
- Fjalëkalimi nuk duhet të përmbajë numra të njëjtë ose të vazhdueshëm (p.sh. 111111, 123456)

Hapi 3 - përcaktoni Pullën Dixhitale si masë sigurie shtesë, e cila do të shfaqet gjatë çdo kyçje në e-banking apo aplikacionin BKT Mobile


- Zgjidhni një kategori nga lista
- Përzgjidhni sipas dëshirës njëren nga pullat dhe klikoni butonin “VAZHDO”



The screenshot shows the 'Regjistrimi' (Registration) screen. It has a sub-header 'Përcaktimi Pullës Dixhitale' (Digital Pull Selection). Below it, there is a paragraph explaining the digital pull selection process. There is a dropdown for 'Kategoria' (Category) set to 'Natyrë' (Nature). There are four image options for digital pulls: a snowy landscape, a path through a forest, a sunset over water, and a field of sunflowers. There is a 'Vazhdo >' button and a Norton logo.

1.2.2 Regjistrimi me kod Unik

Për të filluar regjistrimin në platformën e-banking, pasi që të keni hyrë në ueb faqen e bankës dhe keni zgjedhur e-banking për individ, në faqen e paraqitur duhet të klikoni **“Regjistrohu”**




Hapi 1 - zgjidhni opsionin **“Me Kod Unik”** dhe vendosni kodin Unik (numë 4 shifro) të cilin banka do të dërgojë përmes SMS

Hapi 2 - vendosni një fjalëkalim i cili do të përdoret për kyçjen në e-banking apo aplikacionin BKT Mobile, sipas kriterëve përcaktuar më poshtë:

- Fjalëkalimi duhet të jetë nga 6 deri në 16 karaktere dhe të përmbajë karaktere alfa numerike (shkronja/ numra)
- Fjalëkalimi nuk duhet të jetë i njëjtë me datëlindjen tuaj (DD/MM/VVVV)
- Fjalëkalimi nuk duhet të përmbajë numra të njëjtë ose të vazhdueshëm (p.sh. 111111, 123456)

Hapi 3 - përcaktoni Pullën Dixhitale si masë sigurie shtesë, e cila do të shfaqet gjatë çdo kyçje në e-banking apo aplikacionin BKT Mobile

- Zgjidhni një kategori nga lista
- Përzgjidhni sipas dëshirës njërën nga pullat dhe klikoni butonin **“VAZHDO”**



2. Kyçja në e-banking


Për tu kyçur në platformën e-banking duhet të vizitoni ueb faqen e bankës <https://bkt-ks.com/> dhe të përzgjidhni pjesën “e-banking” për individ. Zgjidhni njërën mënyrë të identifikimit në platformë.

Kyçja mund të bëhet me:

- ✓ Numër klienti/ letërnjoftimi dhe me fjalëkalim
- ✓ Me kartë dhe PIN të kartës tuaj

2.1 Kyçja me numër të klientit/letërnjoftimi

Pasi të jetë hapur dritarja e kyçjes, zgjidhni opsionin “**Me numër të klientit**” dhe vendosni të dhënat tuaja.




Hapi 1 - Vendosni numrin e klientit apo numrin personal,

Hapi 2 - Vendosni fjalëkalimin,

Hapi 3 - Konfirmimi “Pullën Dixhitale” dhe

Hapi 4 - vendosni FNP e pranuar me SMS nga banka



Shënim


Gjatë vendosjes së fjalëkalimit, për shkakë sigurie do të hapet tastiera virtuale e cila ju mundëson të shkruani duke klikuar mbi të.

Largimi i tastierës virtuale bëhet duke larguar shenjën “tick” para tekstit “Përdor Tastierën Virtuale”

Nëse pulla dixhitale e shfaqur nuk korrespondon me formatin të cilin ju e keni përzgjedhur, mos vazhdoni kyçjen dhe njoftoni bankën menjëherë në numrin 038666666

2.2 Kyçja me të dhënat e kartës dhe kodin PIN

Pasi të jetë hapur dritarja e kyçjes, zgjidhni opsionin **“Me kartë”** dhe vendosni të dhënat e kartës tuaj



Hyrje

Me Numër Klienti | **Me Kartë**

Numri Kartës

5236-XXXX-XXXX-1616

Kodi PIN

Ditëlindja

20-08-1984

☐ Përdor Tazierën Virtuale

Vazhdo >



Regjistrohu tani

BKT nuk do t'ju dërgojë asnjëherë emaille ku kërkohet të verifikoni/ndryshoni fjalëkalimet tuaja ose të ndryshoni ndonjë informacion tuajin personal. Ju lutem të mos kryeni asnjë veprim bankar në kompjutera në përdorim nga publik i gjërë (p.sh internet kafe).

Në rast se nuk mbani mend Numrin e Klientit tuajin, ju mund ta mësoni atë nëpërmjet 038 666 666 Shërbimit të Klientit të BKT ose të gjithë degëve të saj. Për një informacion më të mirë të BKT E-Banking ne ju sugjerojmë ta përdorni atë nëpërmjet Mozilla Firefox ose Internet Explorer 7 dhe versionet më larg.

Hyrje

Pulla Dixhitale

Mos vazhdoni më tej në rast se nuk jeni të sigurt për Pullën tuaj Dixhitale të shfaqur në ekran. Klikoni mbi kuti kuadratin blu në rast se konfirmoni se imazhi i shfaqur është Pulla juaj Dixhitale



Vazhdo >



BKT nuk do t'ju dërgojë asnjëherë emaille ku kërkohet të verifikoni/ndryshoni fjalëkalimet tuaja ose të ndryshoni ndonjë informacion tuajin personal. Ju lutem të mos kryeni asnjë veprim bankar në kompjutera në përdorim nga publik i gjërë (p.sh internet kafe).

Në rast se nuk mbani mend Numrin e Klientit tuajin, ju mund ta mësoni atë nëpërmjet 038 666 666 Shërbimit të Klientit të BKT ose të gjithë degëve të saj. Për një informacion më të mirë të BKT E-Banking ne ju sugjerojmë ta përdorni atë nëpërmjet Mozilla Firefox ose Internet Explorer 7 dhe versionet më larg.


Hapi 1 - Vendosni të dhënat kartës tuaj,

Hapi 2 - Vendosni PIN të njëjtës kartë,

Hapi 3 - Vendosni datëlindjen tuaj

Hapi 4 - Konfirmoni “Pullën Dixhitale” dhe

Hapi 5 - Vendosni FNP e pranuar me SMS nga banka



Hyrje

Vendos kodin FNP

Ju lutem plotësoni kodin FNP që ju është dërguar në numrin tuaj të celularit 38344XXX119

Vendos kodin FNP

1:59

Vazhdo >



BKT nuk do t'ju dërgojë asnjëherë emaille ku kërkohet të verifikoni/ndryshoni fjalëkalimet tuaja ose të ndryshoni ndonjë informacion tuajin personal. Ju lutem të mos kryeni asnjë veprim bankar në kompjutera në përdorim nga publik i gjërë (p.sh internet kafe).

Në rast se nuk mbani mend Numrin e Klientit tuajin, ju mund ta mësoni atë nëpërmjet 038 666 666 Shërbimit të Klientit të BKT ose të gjithë degëve të saj. Për një informacion më të mirë të BKT E-Banking ne ju sugjerojmë ta përdorni atë nëpërmjet Mozilla Firefox ose Internet Explorer 7 dhe versionet më larg.

3. Faqja Kryesore

Pasi të jeni kyçur në e-banking, në faqen kryesore do të mund të verifikoni të gjitha fondet që dispononi në bankë, të ndara në:

Asetet: është një përmbledhje e Llogarive, Depozitave, Kursimeve, që dispononi. Këto janë të paraqitura grafiksht sipas peshës në përqindje (%) që secila prej tyre zë në portofolin tuaj.


Gjendja e Disponueshme: është një përmbledhje e gjendjes aktuale që mund të përdoret për të shpenzuar nga të gjitha llogaritë që keni të hapur. Nëse klikoni shiko detajet do të jenë të renditura shumat e të gjitha llogarive, përkatësisht për çdo monedhë. Grafiksht monedhat e verdha paraqesin balancën tuaj, ndërsa ato gri balancën e Mbitërheqjes/Overdraft.

Limiti i Disponueshëm i Kartave të Kreditit: është limiti në monedhën EUR i qasshëm nga të gjitha kartat e kreditit Visa ose MasterCard që zotëroni. Nëse klikoni shiko detajet do të shihni shumën totale të përdorur nga karta e kreditit, limitin total të saj dhe gjithashtu shpërndarjen e shpenzimeve në 6 muajt e fundit.

Kursi i Këmbimit: është një informacion mbi normat e këmbimit valutor në EUR për monedhat kryesore. Nëse klikoni shiko detajet shfaqet kursi i këmbimit historik për muajin e fundit për 3 valutat kryesore.

Veprimet e Fundit: në këtë menu shfaqet lista e 10 transaksioneve të fundit të kryera.

Kalendar: në këtë menu shënohen me ngjyra datat ku keni kryer veprim dhe gjithashtu listohen veprimet e kryera në muajin e fundit. Nëse klikoni secilën datë të ngjyrosur do të shfaqet emërtimi i transaksionit të kryer në atë datë.



The screenshot shows the BKT E-Banking Main Page (Faqja Kryesore) with a sidebar menu on the left and a main content area. The sidebar menu includes options like Faqja Kryesore, Llogaritë, Depozitat, Kartat e Debitit, Kartat e Kreditit, Transferrat, Pagesat, Shërbimet, Kredite, Kredi Dixhitale, Investimet, and Personalizime. The main content area displays several widgets: Asetet (Assets) showing a donut chart with 911.78 EUR; Gjendja e Disponueshme (Available Balance) showing a bar chart with 911.78 EUR; Limiti Disponueshëm i Kartës (Available Card Limit) showing a blue cup icon with 96,872.88 EUR; Kursi i Këmbimit (Exchange Rate) showing a table of exchange rates for AUD, CHF, and USD; Veprimet e Fundit (Recent Transactions) showing a list of transactions; and a Kalendar (Calendar) for DHJ 2020. A banner at the bottom right promotes BKT's digital services.

Në ekran e paraqitur, duke klikuar butonin  në anën e majtë do të hapet lista e veprimeve/shërbimeve të cilat mund të i kryeni në e-banking, për të zgjedhur një të klikoni mbi veprimin/shërbimin e nevojshëm për të vazhduar.

Në faqen kryesore keni edhe këto opsione:


➤ Menutë e Preferuara ★

Në Menutë e Preferuara do të shfaqen menutë e përzgjedhura prej klientit si më të përdorurat prej tij. Në emërtimin e çdo menuje do të shfaqet një "yll ★" i cili nëse klikohet e shton këtë menu në listën e menuve të preferuara. Kjo listë mund të përdoret si një rrugë e shkurtër për të shkuar në menutë më të përdorura.

➤ Njoftime nga aplikacioni BKT Mobile

Këtu ju shfaqet lista e njoftimeve të fundit të dërguara në BKT Mobile . Nëse klikoni në opsionin "Konfiguro Njoftimet" ju shfaqet lista e veprimeve për të cilat do të njoftoheni nga BKT në telefonin tuaj, që keni përdorur për të hyrë në BKT Mobile herën e fundit. Nga lista ju mund të zgjidhni veprimet për të cilat doni të njoftoheni. Zgjedhjen do ta kryeni duke:

- ✓ Klikuar tek butoni Konfiguro
- ✓ Zgjidhni nga lista veprimet që doni të njoftoheni me anë të grupit
- ✓ Klikoni "RUAJ"



4. Funksionet dhe Shërbimet në e-banking

4.1 Llogaritë

Në këtë menu mund të shihni hollësitë dhe transaksionet e llogarive të hapura apo të hapni një llogari të re. Veprimet që mund t'i kryeni në këtë menu janë:

- ✓ Llogaritë e mia - të shihni hollësitë dhe transaksionet e llogarive
- ✓ Hapje Llogarie - të hapni një llogari të re.

4.1.1 Llogaritë e mia

Në këtë menu mund të shihni hollësitë dhe transaksionet e llogarive, gjendjen e disponueshme dhe valutën në të cilën janë hapur llogaritë. Po ashtu në këtë menu mund të kryhen edhe këto veprime:

Detajet e Llogarisë: mund të shikoni detajet e llogarisë si gjendjen në dispozicion për përdorim të llogarive dhe gjendjen e përgjithshme (nëse ka ndonjë shumë të bllokuar ose të paautorizuar), kodin IBAN, degën etj.

Pasqyra e Llogarisë: mund të shikoni pasqyrën e llogarisë me detaje, zgjidhni datën ose shumën për të shikuar transaksionet e kryera për periudhën e zgjedhur. Gjithashtu mund të merrni pasqyrën e llogarisë në mënyrë elektronike duke e zgjedhur opsionin në listën e transaksioneve. Informacionin mbi pasqyrën e llogarisë mund ta ruani ose ta printoni.

Veprimet e Llogarisë: mund të shikoni listën e transaksioneve të kryera në llogari pa detaje. Gjithashtu mund të merrni pasqyrën e veprimeve në mënyrë elektronike duke e zgjedhur opsionin në listën e transaksioneve. Informacionin mbi pasqyrën e veprimeve mund ta ruani ose ta printoni.

Lista e Llogarive të mia ★
 Llogarite e Mia Rrjedhese

EUR	Numri Llogarisë 1901217940311118	Emri Llogarisë ACDESC_701217940	Gjendja 434.38 EUR	Gjendja Disp. 430.70 EUR
IBAN XK051901217940311118		Tipi Llogarisë Kursimi- EUR	Dega BKT - NJESIA PEJTON PRISHTINE	
Data e Hapjes 19.12.2008		Limiti i Overdraftit 1,500.00 EUR	Shuma e Bllokuar 3.68 EUR	

View Statements
 View Transactions

4.1.2 Hapje e llogarisë rrjedhëse

Në këtë menu mund të hapni një llogari rrjedhëse të re, në të gjitha valuta të cilat ofrohen nga banka (EUR, USD, GBP etj.).

Për të kryer veprimin ju duhet të ndiqni hapat e mëposhtëm:

- Përcaktoni monedhën në të cilën do të hapni llogarinë
- Vendosni një emërtim për llogarinë tuaj, në këtë mënyrë mund ta dalloni lehtësisht.
- Përcaktoni nëse dëshiron të merrni në mënyrë automatike gjendjen e llogarisë përmes email-it*
- përcaktoni frekuencën e dërgimit (javore, mujore,...) dhe
- përcaktoni periudhën e fillimit (çdo datë 1 apo datë tjetër)

*Nëse nuk keni një e-mail adresë, ose dëshironi të ndryshoni adresën aktualen, mund të kryeni këtë veprim tek Menu-Personalizime nën menu Informacion Kontakti.



Pasi të keni plotësuar fushat përkatëse për të vazhduar në faqen konfirmuese klikoni butonin **“VAZHDO”**.

Në faqen përmbledhëse do ju shfaqet të dhënat e llogarisë:

- Nëse mendoni se të dhënat janë të sakta, klikoni butonin **“VAZHDO”**
- Nëse jo, klikoni butonin **“ANULLO”** për të ndryshuar të dhënat.



Shënim

Informacionin lidhur me komisionet për llogaritë mund ti gjeni në çmimoren aktuale të publikuar në faqen zyrtare të bankës

5. Depozitat

Në këtë menu do të mund të shihni depozitat aktuale të hapura apo mund të hapi një depozitë të re. Veprimet që të kryhen në këtë menu janë:



Depozitat e Mia – të shihni depozitat tuaja aktuale

Hapje Depozite – të hapni një depozitë të re

5.1 Depozitat e Mia

Në këtë faqe do të shfaqet lista e kontratave të depozitave aktive dhe jo aktive me detajet përkatëse.

Për të parë detajet e kontratës, fillimisht duhet të zgjidhni depozitën dhe më pas klikoni shigjetën - butonin **“DETAJE”**.

Lista e Kontratave të Depozitave të Mia ★

Depozitat e Mia

Kërko

XLS PDF

Numri Kontratës	Data Fillimit	Data Maturimit	Statusi	Interesi	Shuma	Norma Interesit
701DSM1161170001	26.04.2016	26.05.2016	Likujduar	0.00 EUR	500.00 EUR	%0.05

Tipi i Rinovimit: N/A

Periudha e Maturitetit: 30

Tipi i Depozitës: DSM1

Rinovim: Jo

Dega: BKT - NJESIA PEJTON PRISHTINE

Dërgo me email

1 - 1 of 1 items


« 1 »

5.2 Hapja e depozitës

Tek menu “Hapje Depozite”, mundësohet hapja e një depozite të re me fondet të cilat i posedoni në llogaritë tuaja. Hapja e depozitës mund të bëhet në dy forma:

- Hapja e një depozite nëpërmjet Listës së Produkteve të Bankës
- Hapja e depozitës sipas afatit të maturimit

5.2.1 Hapja e një depozite nëpërmjet Listës së Produkteve të Bankës



Hapja e një Depozite ★

Hapje Depozite

HAPJE DEPOZITE NËPËRMJET LISTËS SË PRODUKTEVE TONA

BKT ofron një gamë të gjerë të Depozitave me Afat, me maturitet nga një (1) muaj deri në pesë (5) vite. Parat e investuara në secilën prej Depozitave me Afat, jo vetëm që janë të siguruar por edhe garantojnë përfitim konkurrues të interesit. Nëse zgjidhni që fondet tuaja të qëndrojnë në bankë për periudhë më të gjatë kohore atëherë duhet të zgjidhni Depozitën Progressive. “Depozita Progressive” është produkti më unik i ofruar në treg me maturitet 60 muaj. Nëse ju keni nevojë për ato mjete para maturimit, atëherë BKT sërish ju shpërblen me një interes të caktuar varësisht prej kohës sa i keni mbajtur mjetet e afatizuara në bankë.

Hape tani >


HAPJE DEPOZITE NËPËRMJET DATËS SË MATURITETIT QË JU DËSHIRONI

Nëse jeni duke kërkuar një depozitë me maturitet që i përshkruan planifikimet tuaj atëherë Depozita Elastike është zgjidhja juaj ideale. Karakteristikat:

- Mund të zgjidhni vet kohën e maturimit të depozitës tuaj, nga 32 deri në 1094 ditë.
- Interesi përfitohet në ditën e maturimit të depozitës dhe humbet në rast të mbylljes së parakohëshme të kontratës.
- Depozita elastike është e pa-rinovueshme automatikisht.

Hape tani >

Pasi të zgjidhni mënyrën e hapjes së një depozite, do të shihni listën e produkteve të depozitave me detajet e përcaktuara, emrin dhe datën e maturitetit të produktit:



Hapja e një Depozite ★

Hapje Depozite

Kërko

Emri Produktit • Data Maturimit • Shuma Minimale •

☐	Depozite Avans 1 VJECARE PER PERSONELIN	23.09.2021	500.00 EUR Equivalent
☒	DEPOZITA 6 MUJORE PER PERSONELIN	22.03.2021	30.00 EUR Equivalent
☐	Depozite Avans 6 Mujore PER PERSONELIN	22.03.2021	500.00 EUR Equivalent
☐	DEPOZITA 3 MUJORE PER PERSONELIN	23.12.2020	30.00 EUR Equivalent

5 - 8 of 9 items

Shuma ★ 500.00

Monedha ★ EUR - EURO

Llogarite

Fushat e detyrueshme janë me ★

< Kthehu Vazhdo >

Për të vazhduar tutje me hapjen e kontratës së depozitës duhet të ndiqni këto hapa:

Hapi 1 - Zgjidhni produktin nga lista e produkteve dhe maturitetin

Hapi 2 - Shkruani shumën që dëshironi të depozitoni dhe përcaktoni monedhën/valutën. Për të parë përqindjese interesit klikoni butonin “Llogarite” dhe përqindja e interesit do të shfaqet automatikisht dhe klikoni butonin **“VAZHDO”**

Hapi 3 - Për të vazhduar me hapjen e depozitës klikoni butonin


Hapi 4 - Në faqen tjetër do të shfaqen hollësitë e depozitës për produktin e zgjedhur dhe lista e llogarive tuaja në bazë të monedhës/valutës së përzgjedhur

Hapi 5 - Shumën dhe interesin e depozitës

Hapi 6 - Për të përfunduar transaksionin zgjidhni një nga llogaritë për tërheqjen e parave

- Mund të vendosni që të rinovoni automatikisht depozitën tuaj duke zgjedhur opsionin "PO". Në të kundërt zgjidhni opsionin "JO"
- Renovimi i depozitës mund ta bëni duke rinovuar :
- Principalin apo
- Principal+Interes-Taksë
- Shfletoni kushtet dhe konditat e depozitës dhe klikoni butonin **"Pranoj"**
- Për të vazhduar klikoni butonin **"VAZHDO"** nëse doni të bëni ndryshime klikoni butonin **"KTHEHU"**
- Kontrata e hapjes së depozitës do të dërgohet në e-mail adresën tuaj automatikisht pas përfundimit

5.2.2 Hapja e një depozite nëpërmjet Datës së Maturitetit



Hapja e një Depozite ★

Hape Depozite

HAPJE DEPOZITE NËPËRMJET LISTËS SË PRODUKTEVE TONA

BKT ofron një gamë të gjerë të Depozitave me Afat, me maturitet nga një (1) muaj deri në pesë (5) vite. Parat e investuara në secilën prej Depozitave me Afat, jo vetëm që janë të siguruara por edhe garantojnë përfitim konkurrues të interesit. Nëse zgjidhni që fondet tuaja të qëndrojnë në bank për periudhë më të gjatë kohore atëherë duhet të zgjidhni Depozitën Progressive. "Depozita Progressive" është produkti më unik i ofruar në treg me maturitet 60 muaj. Nëse ju keni nevojë për ato mjete para maturimit, atëherë BKT sërisht ju shpërblen me një interes të caktuar varësisht prej kohës sa i keni mbajtur mjetet e afatizuara në bankë.

HAPJE DEPOZITE NËPËRMJET DATËS SË MATURITETIT QË JU DËSHIRONI


Nëse jeni duke kërkuar një depozitë me maturitet që i përshkruan planifikimin tuaj atëherë Depozita Elastike është zgjidhja juaj ideale. Karakteristikat:

- Mund të zhgjidhni vet kohën e maturimit të depozitës tuaj, nga 32 deri në 1094 ditë.
- Interesi përfitohet në ditën e maturimit të depozitës dhe humbet në rast të mbylljes së parakohëshme të kontratës.
- Depozita elastike është e pa-rinovueshme automatikisht

Hape tani >

Hape tani >

Pasi të zgjidhni mënyrën e hapjes së një depozite, do të shihni listën e produkteve të depozitave me detajet e përcaktuara, emrin dhe datën e maturitetit të produktit:



Hapja e një Depozite ★

Hape Depozite

HAPJE DEPOZITE

Nëse kërkon të hapni një depozitë me afat maturimi të personalizuar sipas nevojave tuaja, Depozita Elastike është zgjidhja perfekte për ju. Ju mund të zgjidhni se kur ju nevojiten interesi dhe paratë tuaja dhe sipas zgjidhjes do të llogaritet afati dhe interesi i depozitës suaj. Depozita Elastike është e përshatshme thjesht dhe vetëm për ju. Me Depozitën Elastike mund të zgjidhni maturitete 32-360 ditë ose 737-1094 ditë.

Data Maturimit★

23-01-2021

Shuma★

500.00

Monedha★

EUR - EURO

Interesi

0.1 %

Llogarite

Për të mbyllur Marrëveshjen e Depozitës, duhet të vizitoni një nga Degët e BKT-s!

Fushat e detyrueshme janë me ★

< Kthehu

Vazhdo >

Për të vazhduar tutje me hapjen e kontratës së depozitës duhet të ndiqni këto hapa:

- Përcaktoni maturitetin për të cilën do të hapni depozitën
- Shkruani shumën që dëshironi të depozitoni dhe përcaktoni monedhën/valutën. Për të parë përqindjen e interesit klikoni butonin **"Llogarite"** dhe përqindja e interesit do të shfaqet automatikisht
- Për të vazhduar me hapjen e depozitës klikoni butonin **"VAZHDO"**
- Në faqen tjetër do të shfaqen hollësitë e depozitës për maturitetin e zgjedhur dhe lista e llogarive tuaja në bazë të monedhës/valutës së përzgjedhur
- Shumën dhe interesin e depozitës
- Për të përfunduar transaksionin zgjidhni një nga llogaritë për tërheqjen e parave
- Shfletoni kushtet dhe konditat e depozitës dhe klikoni butonin **"Pranoj"**
- Për të vazhduar klikoni butonin **"VAZHDO"** nëse doni të bëni ndryshime klikoni butonin **"KTHEHU"**
- Kontrata e hapjes së depozitës do të dërgohet në e-mail adresën tuaj automatikisht pas përfundimi

*Mbyllja e kontratës së depozitës mund të bëhet vetëm duke vizituar degën.

Shënim

Informacionin lidhur me normat e interesit mund ti gjeni në çmimoren e publikuar në faqen zyrtare të bankës
Shuma minimale për hapje të Depozitës është 500 EUR
Renovimi automatik i kontratës së depozitës do të bëhet me normën e interesit të asaj periudhe

6. Karta e Debitit

Në këtë menu mund të shihni kartat e debitit, të lidhni ose të ndani një llogari tjetër me kartën e debitit.

Veprimet që do të kryeni janë:

- Kartat e mia: të shihni detajet e kartave tuaja të debitit që keni në BKT.
- Lidhje me një llogari: krijoni një lidhje ose mund të ndani llogaritë tuaja me kartën e debitit.

Në këtë ekran paraqiten informatat si më poshtë:

- Tipi i kartës: Master/ Visa
- Numri i kartës: Shfaqet pjesërisht i koduar për shkaqe sigurie
- Kartë mbajtësi: Emër, Mbiemër
- Gjendja e llogarisë: gjendja totale e llogarisë së lidhur me kartën (bashkë me shumat e bllokuara ose të paautorizuara, nëse ka)
- Gjendja e disponueshme: gjendja që klienti mund të përdorë me kartë

Lista e Kartave të Mia të Debitit ☆

Kartat e Debitit

XLS PDF

Tipi i Kartës	Numri i Kartës	Mbajtësi	Gjendja Llogarisë	Gjendja Disp.
	6775 XXXX XXXX 8190	FIRSTNAME LASTNAME 7	434.38 EUR	430.70 EUR
	4191 XXXX XXXX 1892	FIRSTNAME LASTNAME 7	434.38 EUR	430.70 EUR
	4191 XXXX XXXX 0195	FIRSTNAME LASTNAME 7	434.38 EUR	430.70 EUR

1 - 3 of 3 items

6.1 Lidhja e Llogarisë

Në këtë menu mund të lidhni kartën e debitit edhe me 4 llogari rrjedhëse të hapura në BKT, pavarësisht monedhës së llogarisë na cila mund të bëni tërheqje të mjeteve në ATM.

Lidhja e llogarive me kartën e debitit kryhet duke:

- Zgjedhur kartën e debitit (llogaria kryesore është gjithmonë e zgjedhur)
- Zgjidhni nga lista e llogarive të palidhura, llogarinë që doni të lidhni, klikoni **LIDHE**,

6.2 Ndarja e Llogarisë


Në këtë menu mund të ndani kartën e debitit me llogaritë e lidhura më herët. Kjo mundëson të mos shfaqen e llogaritë tjera në ATM.

Ndarja e llogarive me kartën e debitit kryhet duke:

- Zgjedhur kartën e debitit (llogaria kryesore është gjithmonë e zgjedhur dhe nuk mund të ndahet)
- Zgjidhni nga lista e llogarive dytësore llogarinë që doni të ndani nga karta e debitit, klikoni **NDAJE**

7. Karta e Kreditit

Në këtë menu do të keni mundësi që të shihni informacionin e kartës së kreditit dhe të kryeni transaksione me kartë të kreditit. Veprimet që do të mund kryeni në këtë menu janë:



Kartat e mia: mund të shihni të gjitha informatat e kartave të kreditit

Limiti në Internet: mund të ndryshoni limitin e përdorimit të kartelës në internet

Pagesat e kartës: mund të kryeni pagesat e kartës së kreditit nga llogaritë tuaja.

Pagesë Kartë Tjetër: mund të paguani një kartë krediti tjetër në BKT e cila nuk ju përket ju, por mund ti përkasë një të afërmi apo të njohuri tuaj.

Ndaje me Këste: mund të ndani transaksionet e kryera me kartën e kreditit me këste sipas kampanjave në fuqi nga banka.

Paradhënie: mund të kryeni transferta nga limiti i tërheqjes Kesh, që keni në kartën e kreditit, në ndonjërin prej llogarive tuaja në Euro

7.1 Kartat e mia

Në këtë faqe mund të shihni të gjitha hollësitë e kartave të kreditit që keni në BKT. Zgjidhni një nga kartat të kreditit të shihni informacionet si më poshtë:

Pasqyrat: këtu do të shfaqen të gjitha pasqyrat mujore të kartës së kreditit sipas datës së prerjes së pasqyrës. Zgjidhni një nga pasqyrat klikoni butonin **"DETAJE"** për të parë detajet e saj. Tek detajet do t'ju shfaqet lista e transaksioneve të kryera për periudhën e kësaj pasqyre.

Detajet e kartës që mund të shihni:

- Mbajtësi i kartës (Emër, Mbiemër)
- Tipi i kartës (Visa/ Master)
- Numri i kartës, i cili do të shfaqet i koduar pjesërisht (për shkaqe sigurie)
- Kryesore/ Dytësore
- Limiti i Kartës, limiti total i kartës
- Limiti i Vlefshëm, limiti i mbetur në kartë
- Data e prerjes, data e nxjerrjes së pasqyrës mujore të kartës
- Data e fundit e pagesës
- Statusi i kartës së kreditit

Veprimet e fundit: këtu do të shfaqen të gjitha transaksionet të cilat janë kryer pas nxjerrjes së fundit të pasqyrës mujore të kartës, të cilat do të reflektohen në prerjen e ardhshme të pasqyrës mujore të kartës së kreditit. Këtu mund të shikoni edhe limitin e mbetur të kartës së kreditit.

Tek menu "Kartat e Mia" do të shfaqen të gjitha kartelat aktive të cilat i posedoni. Për të monitoruar detajet/veprimet duhet të zgjidhni njërin dhe të vazhdoni me hapjen gjendjes së kartelës.

Lista e Kartave të Mia të Kreditit ☆

Kartat e Mia

Tipi Kartës	Numri i Kartës	Mbajtësi	Limiti Mbetur	Data Prerjes	Data Fundit	Statusi
	4191 XXXX XXXX 2900	EMRI MBIEMRI	95,679.00 EUR	N/A	N/A	Aktive
	4191 XXXX XXXX 8737	EMRI MBIEMRI	95,033.00 EUR	N/A	N/A	Aktive
	4191 XXXX XXXX 4278	EMRI MBIEMRI	96,172.08 EUR	N/A	N/A	Aktive
	5236 XXXX XXXX 8716	EMRI MBIEMRI	3,407.08 EUR	24.10.2018	25.10.2018	Aktive

1 - 4 of 4 items


7.2 Ndaje me këste

Në këtë menu do të jepet mundësia që blerjet tuaja në POS të bankave tjera apo online të i ndani me këste. Kjo mundësi do të jetë aktive vetëm atëherë kur të lejohet nga banka në periudhë të caktuar dhe jo për çdo transaksion të realizuar.

7.3 Pagesa e Kartës time

Në këtë menu mund të realizoni pagesën e kartës tuaj duke zgjedhur njërën nga kartelat tuaj aktive dhe llogarinë nga e cila do të bëhet pagesa.

Vlera e pagesës mund të zgjidhet vlera totale apo vlera minimale (mënyra e pagesës është e përcaktuar në aplikim tuaj për kartelë, por mund të ndryshohet) apo mund të vendosni një vlerë tjetër.



✓ Pagesa Automatiqe:

Pagesa Automatiqe kryhet nga sistemi i bankës. Duhet të vendosni limitin që dëshironi të paguani pa qenë nevoja e ndërhyrjeve manuale. Mjafton që ju të zgjidhni 15% për pagesën e detyrimit minimal ose 100% për pagesën e detyrimit të plotë. Banka do të kryejë pagesën deri në limitin e zgjedhur nga ju me datën e caktuar.

✓ Pagesa Manuale:

Nëpërmjet Pagesës Manuale ju mund të kryeni pagesën e kartës sipas detyrimit të pasqyrës së kartës ose çdo vlerë tjetër.

Për të kryer pagesën e kartës së kreditit ju duhet të: zgjidhni kartën e kreditit për të cilën do të kryeni pagesën dhe do të shihni informacionin mbi detyrimin me detajet si më poshtë:

Hapi 1 – Përzgjidhni kartelën të cilën do ta paguani


Hapi 2 – Shihni detyrimin për kartelë e përzgjedhur

- Detyrimi Total
- Shuma minimale: Shuma minimale e detyrimit deri në datën e fundit të pagesës
- Shuma Totale e Ngjitur: Shuma e ngjitur nga detyrimi total
- Shuma Minimale e Ngjitur: Shuma e ngjitur nga detyrimi minimal

Pagesë e Kartës ☆

Pagesa e Kartës

Zgjidhni një kartë për të bërë pagesën e saj



Hapi 3 - zgjidhni llogarinë nga e cila do të kryeni pagesën.

Llogaria e mëposhtme është llogaria me të cilën është e lidhur karta e zgjedhur

	Numri Llogarisë 1960248907311109	Emri Llogarisë ACDESC_760248907	Gjendja -1,381.29 EUR	Gjendja Disp. -1,381.29 EUR
--	--	---	---------------------------------	---------------------------------------

Detajet e Pagesës

Shumë Tjetër ★

0.00 EUR

Shuma e Ngelur Shuma Minimale e Ngelur

☒ Të mos përdoret limiti overdraftit tim edhe në rast se është e nevojshme
☐ Të përdoret limiti overdraftit tim në rast se është e nevojshme

Ndrysho Pagesën Automatike
 Paguaj

Hapi 4 - Zgjidhni metodën e pagesës:

- Shuma Minimale e Ngelur: zgjidhni këtë opsion nëse doni të paguani shumën minimale.
- Shuma e Ngelur: Zgjidhni këtë opsion nëse dëshironi të paguani detyrimin total.
- Shumë Tjetër: Plotësoni çdo shumë tjetër nëse dëshironi të kryeni një pagesë me shumë të ndryshme nga shuma totale ose minimale.
- Klikoni butonin “**PAGUAJ**” dhe më pas “**VAZHDO**” në mënyrë që të përfundoni pagesën

×

Pagesë Karte Krediti

Përmbledhje e Pagesës se Kartës:

Tipi Kartës:	V/C GOLD
Numri Kartës:	4191 XXXX XXXX 9281
Data Veprimit:	23.09.2020
Emri Llogarisë:	ACDESC_760248907
Numri Llogarisë:	1960248907011573
Detyrimi i Ngelur:	0.00 EUR
Minimumi Detyrimit:	0.00 EUR
Shuma Pagesës:	1.00 EUR

☐ Do dëshiroja që të merrja kete faturë në adresën time te emailit(isherifi@bkt.com.al)

Në rast se konfirmoni të dhënat e mësipërme klikoni butonin 'Vazhdo'

Vazhdo ✓
 ose Anullo

7.5 Paradhënie

Në këtë faqe mund të kryeni transferin e limitit të tërheqjes Kesh nga karta e kreditit në ndonjërin prej llogarive në valutën EUR. Limiti i tërheqjes Kesh nga karta e kreditit është 50% e limitit total të kartës.

Informacioni që do të shihni këtu do t'ju ndihmojë të dini:

- Limitin total të tërheqjes Kesh
- Limitin e mbetur për tërheqje Kesh.
- Shumë tjetër
- Pasi të keni përzgjedhur llogarinë ku do të transferohen mjeteve klikoni butonin **"VAZHDO"**

Paradhënie ☆

Paradhënie

Zgjidhni një kartë për të marrë paradhënie nëpërmjet saj

✓	Tipi Kartës V/C GOLD	Numri Kartës 4191 XXXX XXXX 9281	Mbajtësi [Redacted]	Limiti Mbetur 1,011.00 EUR	Data Prerjes 26.02.2015	Data Fundit Pagesës 05.03.2015
---	-------------------------	-------------------------------------	------------------------	-------------------------------	----------------------------	-----------------------------------

Zgjidhni llogarinë TEK e cila dëshironi të derdhni paradhënien

✓	Numri Llogarisë 1960248907311109	Emri Llogarisë ACDESC_760248907	Gjendja -1,381.29 EUR	Gjendja Disp. -1,381.29 EUR
---	-------------------------------------	------------------------------------	--------------------------	--------------------------------

Informacion mbi Paradhënien

Limiti Maksimal i Paradhënies

100.00 EUR

Limiti Mbetur

100.00 EUR

Shumë Tjetër ☆

EUR

Limiti Disp. për Paradhënie

Fushat e detyrueshme janë me ☆

Vazhdo >

7.6 Ndaje me Këste

Në këtë menu shfaqen fushatat aktive për ndarje me këste në e-banking, të transaksioneve të realizuara me kartën e kreditit Prima të BKT online apo në POS të banka tjera.

Në secilën fushatë do të shfaqet numri i transaksioneve të kryera me kartën të cilat mund të ndahen me këste. Nëse klikoni në secilën prej Kampanjave do të shfaqet lista e transaksioneve që mund të ndajmë me këste sipas kësaj Kampanje.

Kampanjat për ndarje me këste lejohen nga banka dhe nuk janë aktive në çdo kohë.

7.7 Pagesa e Kartës të tjerëve

Në këtë menu mund të paguani një kartë krediti tjetër në BKT e cila nuk ju përket ju, por mund ti përkasë një të afërmi apo të njohuri tuaj. Tek menu zgjidhni opsionin për të paguar një kartë tjetër, vendosni numrin e kartel dhe klikoni butonin **"VAZHDO"**

Paguaj Kartë Tjetër ☆

Pagesë Karte Tjetër

Information Information

Information i Kartës së Kreditit

Numri Kartës Krediti

5236 5611 2554 6716

Bank Name

1234 5678 9012 3456

CARDHOLDER

Fushat e detyrueshme janë me ☆


Vazhdo >

7.8 Limiti në Internet

Në këtë faqe mund të ndryshoni limitin e përdorimit të kartave tuaja të kreditit në internet. Për këtë ndiqni hapat e mëposhtëm:

- Zgjidhni kartën e kreditit së cilës dëshironi t'i ndryshoni limitin
- Çaktoni përqindjen që dëshironi të lejoni për përdorim në internet (nga 1% - 100%)

Verifikoni identitetin tuaj duke zgjedhur një nga kartat e kreditit që zotëroni dhe vendosni PIN-in e kartelës (kjo është vetëm një masë sigurie që verifikon identitetin tuaj).



Limiti në Internet

Zgjidhni një kartë për të ndryshuar limitin e saj

Tipi Kartës	Nr. Kartës	Limiti Mbetur	Limiti Total i Kartës	Limiti Online
M/C GOLD	XXXX 0534	854.17 EUR	1,400.00 EUR	55 %

Ndrysho Limitin

Total Credit Card Limit
1,400.00 EUR

Limiti Aktual për Veprimet në Internet:
55 %

Vlerë e Re e Limitit: %

Ky Limiti aplikohet mbi Totalin e Limitit të Kartës së Kreditit.

Fushat e detyrueshme janë me

Vazhdo

8. Transferet

Me anë të kësaj menuje mund të realizoni transferimin e parave nga llogaritë personale, në çdo llogari tjetër brenda BKT-së, brenda vendit apo jashtë vendit.

Përmes menu Transfertat mund të kryhet Transferet dhe veprimet e më poshtme nga llogaria juaj:



Mes Llogarive të mia: Transfertë e parave ndërmjet llogarive të mia

Brenda BKT: Transfertë parash në llogaritë në BKT

Brenda Vendi: Transfertë parash në bankat e tjera vendore

Transferta të regjistruara: Lista e transfertave të regjistruara nga klienti

Historiku Transfertave: Historiku i Transfertave dalëse të kryera nga klienti

Në pritje: lista e transfertave në pritje

Me BKT Shqipërinë: Transfertë parash në llogaritë e BKT Shqipërisë*

Ndërkombëtare: Transfertë parash në bankat e tjera jashtë vendit

*Për të realizuar një transfertë, llogaritë duhet të kenë të njëjtën monedhë/valutë, pra nuk lejohet të bëhet transfertë në mes llogarive me monedhë/valuta të ndryshme.

Shënim

Limitet e transfereve mund ti verifikoni në e-banking
Overdraftit/Mbitërheqjen mund ta shfrytëzoni nëse e keni të lejuar nga banka
Llogaria e Kosovës dhe llogaria e Shqipërisë duhet të ketë të njëjtën monedhë !
Komisionet dhe interesat aplikohen sipas çmimoreve aktuale të publikuar në faqen zyrtare të bankës

8.1 Transfertat mes llogarive të mia

Në këtë menu mund të realizoni transfertë të parave ndërmjet të llogarive tuaja në BKT në të njëjtën valutë.

Për të kryer një transfertë duhet të ndiqni hapat e mëposhtme:

Hapi 1 - zgjidhni llogarinë nga e cila dëshironi të bëhet transferi

Hapi 2 - zgjidhni llogarinë tek e cila dëshironi të bëhet transferi

